

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2014, miratoi këtë:

Rregullore për Sistemin e Numrave Standardë të Llogarive Bankare

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i strukturës së numrave të llogarive bankare, i marrëdhënieve ndërmjet bankës dhe klientit në lidhje me krijimin, komunikimin dhe përdorimin e numrave të llogarive bankare, si dhe i procedurave për kontrollet e vlefshmërisë së numrave të llogarive bankare.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Subjekte të zbatimit të kësaj Rregulloreje janë bankat komerciale të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).
2. BQK-ja zbaton dispozitat e kësaj Rregulloreje në rolin e operatorit për kryerjen e pagesave për klientët e saj.

Neni 3 Përkufizime

Në zbatim të kësaj Rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “bankë” nënkupton një subjekt të përcaktuar me Ligjin Bankar;
- b) “BBAN” (Basic Bank Account Number) nënkupton numrin bazë të llogarisë bankare, i cili paraqet një kod numerik, që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare brenda vendit;
- c) “IBAN” (International Bank Account Number) nënkupton numrin ndërkombëtar të llogarisë bankare, i cili paraqet një kod alfanumerik, që është një version i zgjeruar i BBAN-it dhe që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare në nivel ndërkombëtar; ai

- përcaktohet në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 13616;
- d) “SWIFT BIC” (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication Business Identification Code) nënkupton kodin e identifikimit unik ndërkombëtar të bankave, që përfaqëson një kod i cili identifikon në nivel ndërkombëtar një bankë të licencuar për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Kosovës; ai përcaktohet në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 9362;
 - e) “KIB” nënkupton kodin e identifikimit bankar, që është një kod numerik që përdoret për të identifikuar një bankë, së bashku me degën e saj të licencuar në nivel kombëtar, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Kosovës; ai përcaktohet nga BQK-ja;
 - f) “kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it/BBAN-it” nënkupton vlerësimin e saktësisë së kodit të kontrollit të IBAN-it/BBAN-it;
 - g) “STP” (Straight-Through Processing) nënkupton procesimin automatik të transfereve të fondeve. Inicohet duke debituar llogarinë e urdhëruesit të pagesës dhe përfundon me kreditimin e llogarisë së përfituesit të fondeve, pa ndërhyrje manuale apo të tilla që kërkojnë kujdes njerëzor;
 - h) “klient” nënkupton mbajtësin e një llogarie (pronarin e llogarisë) në një bankë;
 - i) “urdhërpagesë” nënkupton çdo udhëzim nga paguesi apo i paguari dhënë institucionit të tij/saj të pagesave ku kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesës;
 - j) “ISO” (International Organization for Standardization) nënkupton Organizatën Ndërkombëtare për Standardizim;
 - k) “SWIFT” (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) nënkupton kompaninë e cila ofron komunikimin global të sigurt të mesazheve financiare;
 - l) “degë e bankës” nënkupton degën dhe/ose nëndegën e një banke në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 4

Funksionet e numrave standardë të llogarive

Përdorimi i numrave standardë të llogarive nga bankat, bëhet me qëllim të përmbushjes së funksioneve të mëposhtme:

- a) përpunimin automatik gjatë identifikimit të llogarive bankare, duke ndihmuar kryerjen e procesimit STP; dhe
- b) unifikimin dhe standardizimin e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarive bankare.

Neni 5

Elementet përbërëse të numrave standardë të llogarive

1. IBAN-i në Republikën e Kosovës përbëhet prej 20 karakteresh alfanumerike dhe përfshin elementet e mëposhtme:
 - a) **kodi i Republikës së Kosovës**, që është i përbërë prej 2 karaktereve: “XK“, të cilat janë të përcaktuara në Regjistrin e IBAN-it në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 3166-1;

- b) **kodi kontrollues i IBAN-it**, që është i përbërë prej 2 karakteresh, të cilat përcaktohen në përputhje me metodën e kalkulimit MOD 97-10 në bazë të standardit ndërkombëtar ISO 7064;
 - c) **BBAN**, që është i përbërë prej 16 karakteresh, të përcaktuara ashtu siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni.
2. BBAN-i përbëhet prej 16 karakteresh numerike dhe përfshin elementet e mëposhtme:
- a) **KIB-i**, që është i përbërë nga 4 karaktere numerike, të cilat përcaktojnë në mënyrë unike bankën dhe degën e asaj banke në të cilën është hapur llogaria e klientit;
 - b) **numri i klientit**, që është i përberë nga 10 karaktere numerike, të cilat përcaktohen nga vetë bankat.
 - c) **kodi kontrollues i BBAN-it**, që është i përbërë nga 2 karaktere numerike, të cilat përcaktohen në përputhje me metodën e kalkulimit MOD 97-10 në bazë të standardit ndërkombëtar ISO 7064.

Neni 6

Forma e paraqitjes së numrave standardë të llogarive

1. IBAN-i paraqitet:
- a) në instruksionet elektronike të pagesave – pa hapësira ose simbole ndarëse mes karaktereve përbërëse; dhe
 - b) në dokumentet e pagesave në format letër – sipas grupimit prej 4 karakteresh të ndara me nga një hapësirë.
2. BBAN-i paraqitet:
- a) në instruksionet elektronike të pagesave – pa hapësira ose simbole ndarëse mes karaktereve përbërëse; dhe
 - b) në dokumentet e pagesave në format letër – pa hapësira ose simbole ndarëse mes karaktereve përbërëse ose sipas grupimit prej 4 karakteresh të ndara me nga një hapësirë.

Neni 7

Krijimi dhe komunikimi i numrave standardë të llogarive

1. Banka krijon dhe mirëmban IBAN-in dhe BBAN-in për çdo llogari në përputhje me nenin 5 dhe anekset 1 dhe 2.
2. Banka mban përgjegjësi ndaj klientit për saktësinë IBAN-it dhe BBAN-it.
3. Banka i komunikon çdo klienti IBAN-in dhe BBAN-in e llogarisë së tij në mënyrë të shtypur ose elektronike.
4. IBAN dhe BBAN korrespondojnë në mënyrë unike dhe mund të derivohen nga njëri-tjetri.

Neni 8

Përdorimi i numrave standardë të llogarive

1. Për pagesat ndërkombëtare, IBAN-i është format parësor në përdorim.
2. Për pagesat vendore, si për ato ndërbankare ashtu edhe për ato brenda bankës, BBAN-i është format në përdorim.

Neni 9

Kontrolli i vlefshmërisë së numrave standardë të llogarive

1. Banka e cila përpunon dhe ekzekuton urdhërpagesën, kontrollon vlefshmërinë e IBAN-it për pagesa ndërkombëtare dhe të BBAN-it për pagesa vendore. Nëse identifikohet pasaktësi nga kontrolli i vlefshmërisë, banka refuzon të kryejë pagesën përkatëse.
2. Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it dhe BBAN-it realizohet në përputhje me “Metodën e llogaritjes së kodeve kontrolluese të IBAN-it dhe BBAN-it”, të përcaktuar në aneksin 2.
3. Sistemet kombëtare të pagesave kontrollojnë vlefshmërinë e BBAN-it për urdhërpagesat që kryhen përmes këtyre sistemeve dhe në rast pasaktësie refuzojnë procesimin dhe shlyerjen e tyre.

Neni 10

Kodi identifikues bankar (KIB)

1. KIB përbëhet nga 4 karaktere numerike:
 - a) **kodi i bankës**, që është i përbërë nga 2 karaktere, të cilat përcaktohen nga BQK-ja për të identifikuar në mënyrë unike çdo bankë. Ky kod mund të jetë nga 10 deri në 99;
 - b) **kodi i degës së bankës**, që është i përbërë nga 2 karaktere, të cilat përcaktohen nga bankat për të identifikuar në mënyrë unike çdo degë të saj. Ky kod mund të jetë nga 00 deri në 99. Për degën kryesore, ky kod duhet të jetë “00”.
2. Lidhur me kodin e bankës, BQK:
 - a) bën përcaktimin në mënyrë rendore pas dhënies së licencës bankare;
 - b) mirëmban dhe publikon Regjistrin e Kodeve të Bankave;
 - c) informon bankat vendore, për çdo ndryshim në Regjistrin e Kodeve të Bankave;
 - d) informon organizatat e huaja relevante në bazë të aranzhmaneve të veçanta për çdo ndryshim në Regjistrin e Kodeve të Bankave.
3. Lidhur me kodet e degëve të bankave, bankat:
 - a) përcaktojnë kodet që i referohen degëve të tyre;
 - b) njoftojnë BQK-në për krijimin, ndryshimin apo revokimin e kodeve të degëve të bankave.

Neni 11
Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet

Çdo shkelje e dispozitave e kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

Neni 12
Dispozitat kalimtare

Data efektive e formatit IBAN të llogarive bankare të Kosovës do të jetë 1 shkurt 2015. Deri atëherë nga bankat do të kryhen të gjitha përgatitjet teknike dhe njoftimet e klientëve.

Neni 13
Anekset

Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë dy anekse:

- a) Aneksi 1 – Struktura e IBAN-it, dhe
- b) Aneksi 2 – Metoda e llogaritjes së kodeve kontrolluese të IBAN-it dhe BBAN-it.

Neni 14
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet “Rregulla XIX për Sistemin e numrave të llogarive në bankat e Kosovës” e miratuar nga Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës më 19 tetor 2001.


Neni 15
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 shkurt 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

Bedri Peci

Aneks 1 Struktura e IBAN-it



Shembull i IBAN-it

BBAN: KIB+Nr. i klientit+Kd. kontrollues i BBAN-it					1	2	1	2	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	0	6
IBAN: Kodi i shtetit+Kd. kontrollues i IBAN-it +BBAN	X	K	0	5	1	2	1	2	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	0	6

Aneks 2

Metoda e llogaritjes së kodeve kontrolluese të IBAN-it dhe BBAN-it

Me instruksionet në vazhdim, tregohet se si llogariten kodet kontrolluese të IBAN-it dhe BBAN-it. Për këtë qëllim marrim një llogari IBAN e cila përfshin kodin e Kosovës “XK”. Si algoritëm për caktimin e kodeve kontrolluese përdoret standardi ndërkombëtar ISO 7064, MOD 97-10.

Shembull: X K 0 5 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Llogaritja e kodit kontrollues të BBAN-it: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Hapi 1

Siç dihet BBAN paraqet 16 karakteret e fundit të IBAN-it.

Së pari kodit kontrollues i BBAN-it (dy karakteret e fundit të BBAN-it) zëvendësohen me “00”:

1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 0

Hapi 2

Në rezultatin nga Hapi 1 zbatohet algoritmi MOD 97. Mbetja nga zbatimi i MOD 97 në rezultatin nga Hapi 1 është numri “92”.

Hapi 3

Rezultati nga Hapi 2 zbritet nga numri 98, duke fituar kodin kontrollues të BBAN-it. Në rastin tonë kodit kontrollues është “06”: $98 - 92 = 06$. (Në rastet kur rezultati i fituar ka vetëm një karakter, atëherë shtohet “0” para rezultatit të fituar.)

Numri BBAN, i cili përfshin kodin kontrollues nga Hapi 3, është 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Për të vërtetuar saktësinë e BBAN-it, mbetja pas aplikimit të MOD 97 në BBAN (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6) duhet të jep rezultatin “1”.

Llogaritja e numrit kontrollues të IBAN-it: X K 0 5 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Hapi 1

Kodin e shtetit dhe kodin kontrollues të IBAN-it i zhvendosim në fund, pastaj kodin kontrollues e zëvendësojmë me “00” ndërsa shkronjat “XK” zëvendësohen me numra sipas tabelës së mëposhtme:

A = 10	G = 16	M = 22	S = 28	Y = 34
B = 11	H = 17	N = 23	T = 29	Z = 35
C = 12	I = 18	O = 24	U = 30	
D = 13	J = 19	P = 25	V = 31	
E = 14	K = 20	Q = 26	W = 32	
F = 15	L = 21	R = 27	X = 33	

Rezultati: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 X K 0 0, pas konvertimit të shkronjave fitojmë
1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 3 3 2 0 0 0

Hapi 2

Zbatojmë MOD 97 në rezultatin e fituar në Hapin 1: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 3 3 2 0 0 0.
Mbetja nga zbatimi i MOD 97 në rezultatin nga Hapi 1 është numri “93”.

Hapi 3

Rezultati nga Hapi 2 zbritet nga numri 98, i cili paraqet kodin kontrollues të IBAN-it. Në rastin tonë, kodi kontrollues është “05”: $98 - 93 = 05$. (Në rastet kur rezultati i fituar ka vetëm një karakter, atëherë shtohet “0” para rezultatit të fituar.)

Numri IBAN, i cili përfshin kodin kontrollues nga Hapi 3 është X K 05 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Për të vërtetuar saktësinë e IBAN-it, së pari kodin e shtetit dhe kodin kontrollues i zhvendosim në fund, si dhe shkronjat “XK” i konvertojmë në numra. Mbetja pas aplikimit të MOD 97 në shifrën e përgatitur (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 33 20 05) duhet të japë rezultatin “1”.

Shembull i zbatimit të MOD 97

I referohemi shembullit të zbatimit të MOD 97 në BBAN (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6):

- I. 9 karakteret e para të numrit pjesëtohen me 97
 $121201234/97 = 1249497.257$
- II. pjesa e plotë e rezultatit të fituar shumëzohet me numrin 97
 $1249497 * 97 = 121201209$
- III. nga numri i parë 9-karakterësh zbresim numrin e marrë si rezultat në hapin 2
 $121201234 - 121201209 = 25$
- IV. e krijojmë një numër të ri duke bashkëngjitur rezultatin në hapin 3 me 7 karakteret e fundit të BBAN-it, si dhe këtë numër e pjesëtojmë me 97.
 $255678906/97 = 2635865.01$
Në rastin tonë, në këtë hap kemi përfshirë të gjitha karakteret, në të kundërtën kjo procedurë përsëritet derisa të përfshihen në llogaritje të gjitha karakteret.
- V. pjesa e plotë e rezultatit të fituar shumëzohet me numrin 97
 $2635865 * 97 = 255678905$
- VI. nga numri i përgatitur në hapin 4 zbresim rezultatin në hapin 5.
 $255678906 - 255678905 = 1$
Rezultati i fituar paraqet mbetjen pas aplikimit të MOD 97 në 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6.